



## Ndërtimi i Kapaciteteve të Ofruesve të AFP-së në Turizmin e Qëndrueshëm

### Buletini nr. 1

Mirë se vini në edicionin e parë të Buletinit SustainTour!

SustainTour është një projekt trevjeçar Erasmus+ i krijuar për të forcuar kapacitetet e ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në nxitjen e transformimit të qëndrueshëm në sektorin e turizmit në Ballkanin Perëndimor. Duke prezantuar profilin e ri profesional “Këshilltar i Turizmit të Qëndrueshëm”, projekti lidh institucionet e trajnimit me SME-të në fushën e mikpritjes dhe turizmit, duke mbështetur bizneset që të integrojnë praktika të gjelbra, digjitale dhe sociale në operacionet e tyre të përditshme.

### Formësimi i të ardhmes së turizmit në Ballkanin Perëndimor

Turizmi është një motor i rëndësishëm i rritjes dhe punësimit në Ballkanin Perëndimor, megjithatë sektori përballet me sfida në përshtatjen ndaj kërkesave për qëndrueshmëri, digjitalizim dhe pritshmërive të tregut në ndryshim. SustainTour i adreson këto sfida përmes mundësive inovative të trajnimit, lidhjeve më të ngushta midis arsimit dhe tregut të punës, si dhe një fokus të fortë në kompetencat e orientuara drejt së ardhmes.




Co-funded by  
the European Union

Projekti financohet nga Bashkimi Evropian (ID: 101183404).

Megjithatë, pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimit dhe Kulturë (EACEA). Neither the European Union nor EACEA can be held responsible for them.

## Çfarë të Prisni nga SustainTour

Zbuloni **rezultatet kryesore** që do të drejtojnë punën tonë, duke ofruar përfitime konkrete për ofruesit e AFP-së, trajnerët dhe SME-të :



## Progresi Ynë Deri Tani

Në muajt e parë të SustainTour, ne kryem kërkim dytësor (desk research) në Shqipëri dhe Kosovë, duke rishikuar politikat, strategjitë dhe mjetet e qëndrueshmërisë në turizëm në përputhje me standardet evropiane. Kjo na lejoji të identifikojmë nevojat dhe sfidat kryesore me të cilat përballen SME-të në adoptimin e praktikave të qëndrueshme.

Duke u bazuar në këto njohuri, kërkimi në terren përmes **fokus grupeve** në të dy vendet ofroi perspektiva të vlefshme mbi situatën aktuale dhe aftësitë e ardhshme të nevojshme në sektorin e turizmit.

Gjetjet po përpunohen në **Raporte Kombëtare për Shqipërinë dhe Kosovën**, të cilat do të kontribuojnë në një **Raport Krahasues**. Ky raport do të udhëzojë identifikimin e fushave të kompetencave dhe do të mbështesë hartimin e profilit të "Këshilltarit të Turizmit të Qëndrueshëm" dhe kurrikulës së trajnimit.

Këto hapa fillestare kanë krijuar një dinamikë të fortë, duke siguruar që faza tjetër e projektit të adresojë drejtpërdrejt realitetet e sektorit të turizmit në Ballkanin Perëndimor.

## Takimi Fillestar & Workshop-i i Prezantimit – Larisa, Greqi

Partnerët SustainTour u mbledhën në Larisa, Greqi, më 19–21 mars 2025, për takimin e parë të projektit SustainTour.

Takimi Fillestar, i organizuar nga BEE GROUP, vendosi bazat e bashkëpunimit tonë. Partnerët ndanë ekspertizën e tyre, krijuan një kuptim të përbashkët mbi objektivat e projektit dhe diskutuan mënyrën se si do të punojnë së bashku për të formësuar profilin e ri të “Këshilltarit të Turizmit të Qëndrueshëm”. Ky takim ishte gjithashtu një mundësi për të forcuar lidhjet ndërmjet vendeve dhe për të vendosur themelet e një bashkëpunimi të suksesshëm në muajt në vijim.



**KICK-OFF  
MEETING**  
of **SustainTour**

Pas Takimit Fillestar, DIMITRA organizoi një Workshop dy-ditor të Prezantimit, ku partnerët eksploruan mënyrën se si kornizat evropiane, si EQF dhe EQAVET, mund të udhëzojnë hartimin e përmbytjes së trajnimit. Me një kombinim prezantimesh dhe aktiviteteve grupore, workshop-i ndihmoi për të përkthyer teorinë në praktikë dhe inkurajoi reflektimin mbi mënyrën se si rezultatet e të nxënimit mund të mbështesin tranzicionin e sektorit të turizmit drejt rrugëve më të gjelbra, digjitale dhe më gjithëpërfshirëse.

Këto hapa të parë në Larisa krijuan një ndjenjë të fortë partneriteti dhe përgatitën terrenin për punën e rëndësishme që qëndron përpara.

## Partneriteti SustainTour

Ky konsorcium bashkon 8 partnerë nga Greqia, Qipro, Spanja, Shqipëria dhe Kosova, duke bashkuar forcat për të avancuar turizmin e qëndrueshëm përmes inovacionit në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP).

### Partneri udhëheqës: Bee Group (Greqi)



Bee Group me krenari koordinon projektin SustainTour, duke sjellë mbi 30 vjet eksperiencë në

zgjdhje inovative në Greqi dhe Evropë. I vendosur në Larisa, organizata kombinon ekspertizën në transformimin digjital, konsulencën për projekte dhe komunikimin strategjik përmes tre divizioneve të saj: bee.Technology (sisteme dhe platforma e-learning), bee.Consulting (planifikim,

financim dhe menaxhim projektesh), dhe bee.Communication (fushata dhe evente për vizibilitet). Si partner udhëheqës, Bee Group siguron zbatimin e qetë të projektit, nxit bashkëpunimin dhe promovon inovacionin në turizmin e qëndrueshëm me një fokus të fortë mbi ndikimin dhe shkëlqimin.

### Partneri 2: Dimitra Education & Consulting (Greqi)



E themeluar në vitin 1989, DIMITRA është një nga ofruesit kryesorë grekë të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), Arsimit të të

Rriturve dhe Mësimit gjatë gjithë Jetës (Lifelong Learning). E akredituar për AFP-në Fillestare dhe të Vazhdueshme, DIMITRA ka modernizuar sistemin grek të AFP-së dhe kontribuon në iniciativa evropiane për arsimin gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe të bazuar në aftësi. Me qendra trajnimi në pesë qytete dhe certifikim ISO 9001:2015, DIMITRA ofron të nxënit e kombinuar dhe digjital të përshtatur me nevojat e tregut të punës. Ajo sjell ekspertizë në trajnim profesional, qëndrueshmëri dhe ndërtim kapacitetesh, duke mbështetur aftësitë e gjelbra, digjitale dhe gjithëpërfshirëse për ofruesit e AFP-së dhe SME-të në turizëm.

### **Partneri 3: Mediterranean Management Center (Qipro)**



E themeluar në vitin 2002 në Nikozia, MMC fuqizon

organizatat dhe individët përmes trajnimeve, zhvillimit dhe zgjidhjeve inovative të projekteve. Ajo ofron programe të personalizuar në komunikim, udhëheqje, menaxhim projektsh dhe zhvillim personal, të udhëhequra nga konsulentë të njohur ndërkombëtarisht. MMC gjithashtu zbaton projekte të BE-së dhe të bashkëfinancuara që promovojnë arsimin, qëndrueshmërinë, sipërmarrjen dhe përfshirjen, si dhe organizon evente me ndikim, si Konferenca Vjetore për Asistentët Personalë. Me një qasje të fokusuar te klienti dhe një angazhim të fortë ndaj cilësisë, MMC ndihmon organizatat të arrijnë rezultate domethënëse në një botë në ndryshim të shpejtë.

### **Partneri 4: Albacademy (Shqipëri)**



E themeluar në vitin 2017 në Tiranë, Albacademy fuqizon individët

dhe organizatat përmes arsimit dhe trajnimeve me cilësi të lartë. Me ekspertizë në trajnim profesional, qëndrueshmëri dhe ndërtim kapacitetesh, ajo ofron programe profesionale dhe konsulencë të përshtatura për sektorin e turizmit. Duke ofruar mbi 30 kurse në mikpritje, IT, marketing, shitje dhe menaxhim, Albacademy ofron format online, offline dhe të kombinuara për të përmbushur nevoja të ndryshme. Fokusi i saj në menaxhimin e mikpritjes, shërbimin ndaj klientit dhe praktikën e qëndrueshme pajis nxënësit me aftësi të përshtatshme për industrinë, ndërsa projektet e financuara nga BE-ja mbështesin inovacionin dhe rritjen në arsim dhe turizëm.

### **Partneri 5: Kolegji Ndërkombëtar Universum- UNI (Kosovë)**



Kolegji Ndërkombëtar Universum (UNI) është një

institucion udhëheqës i arsimit të lartë në Kosovë, me kampuse në Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë. I akredituar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës dhe duke mbajtur Kartën Erasmus, UNI ofron diploma të njohura në BE. Në partneritet me Arizona State University, UNI ofron diploma të dyfishta, kurrikula ndërkombëtare dhe mundësi mobiliteti përmes mbi 220 projekteve Erasmus+ në 26 vende. UNI ofron programe bachelor dhe master në biznes, IT, dizajn, shkenca shëndetësore, drejtësi, shkenca politike, psikologji dhe më shumë, me fokus në inovacion dhe karriera globale.

### **Partneri 6: Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës – UAMD (Shqipëri)**



UAMD është universiteti publik me rritjen më të shpejtë në Shqipëri, me rreth 20,000 studentë në tre cikle studimi. Si një institucion i orientuar tek studentët, ai nxit të menduarit kritik, përgjegjësinë dhe angazhimin social, duke ofruar diploma në shqip dhe anglisht sipas sistemeve ECTS dhe USC. UAMD udhëheq dhe merr pjesë si partner në projekte të shumta Erasmus+, me mbi 100 marrëveshje mobiliteti ndërkombëtare që mundësojnë shkëmbime të stafit dhe studentëve. Universiteti ka tre qendra kërkimore dhe është pjesë e Aleancës Evropiane të Universiteteve STARS EU. Me infrastrukturë moderne, partneritete të forta dhe fokus në inovacion, UAMD po formëson arsimin e lartë në Shqipëri me një perspektivë globale.

#### Partneri 7: DOCUMENTA (Spanjë)



**documenta**

INSTITUTO EUROPEO  
DE ESTUDIOS PARA LA  
FORMACIÓN Y EL DESARROLLO

E themeluar në vitin 1996, DOCUMENTA është një institucion jofitimprurës për trajnime dhe zhvillim, me përvojë në mbi 70 projekte evropiane dhe partneritete me 230 organizata në 27 vende. Ekipi i saj promovon zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm lokal përmes kërkimeve të

aplikuara, turizmit, sektorëve kulturorë, ekonomisë sociale dhe barazisë së mundësive. Organizata harton kurrikula trajnimi inovative, nxit pjesëmarrjen qytetare, mbështet krijimin e bizneseve dhe përparon përfshirjen sociale. Me ekspertizë në menaxhimin e projekteve, shpërndarje dhe inovacion politikash, ajo ndërton njohuri dhe rrjete që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm territorial

#### Partneri 8: Oda e Mikpritjes dhe Turizmit e Kosovës - CHHT (Kosovë)



CHHT është një organizatë profesionale udhëheqëse që përfaqëson mbi 700 anëtarë në sektorët e hotelerisë, turizmit dhe ushqimit & pijeve në Kosovë. Me shtatë degë

rajonale, ajo luan një rol kyç në promovimin e rritjes dhe konkurrencës së industrisë, duke nxitur bashkëpunimin publik-privat, tërheqjen e investimeve dhe avokimin për reforma. Shërbimet e saj përfshijnë zhvillimin profesional, rrjetëzimin B2B dhe pjesëmarrjen në projekte rajonale dhe në nivel të BE-së. Një fokus i fortë mbi Arsimin dhe Formimin Profesional siguron përputhshmërinë me nevojat e tregut, duke ofruar mbështetje për kurrikulat, praktika dhe mundësi të mësimit gjatë gjithë jetës për të forcuar fuqinë punëtore në turizëm.

**Çfarë vjen më pas? Qëndroni të lidhur me SustainTour!**



Co-funded by  
the European Union

 [www.sustaintour.eu](http://www.sustaintour.eu)  
 SustainTour  
 SustainTour